



**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail. [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)

www. [pallatirinise.com](http://pallatirinise.com)

Nr. 11374 Dt. 22.11.2024

NDËRMARJA PUBLIKE LOKALE PALLATI I RINISË SHA PRISHTINË

RREGULLORE PËR PAGAT DHE KOMPENSIME TË TJERA PËR  
NDËRMARJEN PUBLIKE LOKALE “PALLATI I RINISË” SH.A,  
PRISHTINË.

Prishtinë, 21.11.2024

## **Praktikantët pa pagesë**

1. Ndërmarrja në marrëveshje me përsone fizik apo juridik mund të angazhojë praktikantë pa ndonjë kompensim të pagës dhe të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, përveç që duhet të ofrojë mbrojtje dhe siguri në vendin e punës sipas ligjit.

3. Punëdhënësi i cili e angazhon praktikantin pa kompensim page, është i obliguar ta evidentojë praktikantin në listën e evidencave pa kompensim page.

## **Neni 10 Puna provuese**

1. Punëtori i cili ka themeluar marrëdhënie punë të rregullt në një pozitë të cilën nuk e ka ushtruar me parë, obligohet që të kalojë nëpër punën provuese.
2. Gjatë punës provuese, punëtori merr pagën e plotë mujore, të paraparë për atë vend punë.
3. Puna provuese përfshin periudhën prej tre muajsh dhe e njëjta vlerësohet me shkrim nga eprori përkatës.
4. Pas kalimit të punës provuese me sukses, të punësuarit i hartohet kontrata bazuar në dispozitat e orëtë Ligjit të punës, përveç pozitive për të cilat mandati është i përcaktuar me Ligje të vecanta.

## **Neni 11 Kompensimi për punën me orar të plotë**

1. Për punën e kryer me orar të plotë, punëtori do të merr pagën mujore sipas kategorizimit të vendeve të punës.
2. Orari i plotë i punës nuk mund të përfshijë më shumë se 40 orë në javë, java e punës është 5 ditë.
3. Organizimi i orarit të punës bëhet sipas nevojave të njësive përkatëse.
4. Përfshirë nga paragrafi 2 i këtij Neni në rastet e jashtëzakonshme, maksimumi i orëve shtesë të punës është 8 orë në javë por jo më shumë se 40 orë në muaj.
5. Kalkulimi i pagave mujore dhe orëve shtesë, bëhet nga Departamenti i Financave në bashkëpunim me Udheheqësin e shërbimeve të përgjithshme.
6. Afati i fundit për dorëzimin e evidencave të punës tëk zyrtari përpërnëpërgjegjës, është data e fundit e muajit.

## **Neni 12 Kompensimi për punën**

*Ap.*

1. Puna që kalon mbi 40 orë në javë për punëtorët e Ndërmarrjes konsiderohet punë jashtë orarit dhe llogaritet në shkallën e kompensimit sipas Nenit 56 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.
2. Puna jashtë orarit kërkohet me shkrim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.
3. Kërkesës për punën jashtë orarit, i bashkëngjitet arsytimi me shkrim.
4. Vendimin për lejin e punës jashtë orarit e merr Kryeshefi Ekzekutiv.
5. Bazat e organizimit të punës jashtë orarit janë të përcaktuara me Ligjin e punës.
6. Dokumentacioni mbi lejin e punës jashtë orarit, i dorëzohet Njesisë së Burimeve njerëzore pranë Departamentit të shërbimeve të përgjithshme, bashkë me evidencën e kohës së punës.
7. Puna në ditët e Festave Zyrtare, kompensohet me pagesë shtesë në shkallën 50 % për orë punë ose me ditë të lira në shkallën e njejtë me pagesën.
8. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, punë në ditë të festave zyrtare dhe për punën e natës, i punësuarit ka të drejtë në page shtesë, në pajtim me këtë rregullore dhe Ligjin e Punës.
9. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
  - 9.1. 20 % në orë për kujdestari;
  - 9.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;
  - 9.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;
  - 9.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
  - 9.5. 50 % në orë për punë gjatë fundjavës.
10. Pagesa shtesë për punë gjatë fund javës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra tjetrën.
11. I punësuarit mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi;
12. Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të Ndërmarrjes.

### **Neni 13**

#### **Kompensimet për pushimet me pagesë**

Pagesa për kohën e pushimit vjetor, pushimeve statusore (në rast të martëses së tij/saj, lindjes, dhe vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes) rregullohet sipas legjislacionit dhe

akteve të brendshme në fuqi.

#### **Neni 14**

#### **Komisioni për kryerje të punëve specifike**

1. Kryeshefi Ekzekutiv me vendim, themelon komisione për kryerjen e punëve të vecanta që ndërlidhen me Ndërmarrjen.
2. Kompensimi i komisioneve për kryerjen e punëve specifike bëhet me kompensim të ditëve apo pagese të orëve shtëse, në rastin kur puna e komisionit nuk mund të kryhet gjatë orarit të punës bazuar në nenin 12 të kësaj Rregullore.

#### **Neni 15**

#### **Kompensimi i pushimit mjekësor**

Kompensimi për pushimet mjekësore bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 59 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.

#### **Neni 16**

#### **Kompensimi i pushimit të lehonisë**

Kompensimi i pushimit të lehonisë bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit të Punës.

#### **Neni 17**

#### **Kompensimi në rast të mungesës për shkak të pasigurisë, mbrojtjes dhe shëndetit në punë**

1. Me vendim të organit të autorizuar shtetëror ose me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i punësuarit ka të drejtën e mungesës me arsye nga puna, në rastet kur vlerësohet pasiguria në punë dhe rrezikimi i shëndetit të tij/saj sipas Nenit 61 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212;
2. Gjatë mungesës së përkohshme në punë për shkak të pasigurisë në vendin e punës, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pages. Ky kompensim nuk do të jetë me i gjatë se 45 ditë gjatë një viti kalendarik.

#### **Neni 18**

#### **Udhëtimet zyrtare**

1. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit, në shtetet fqinje ose në shtetet tjera për qëllime zyrtare dhe në interes të Ndërmarrjes duhet të paguhet nga ana e Ndërmarrjes.
2. Para çdo udhëtimi duhet plotësuar autorizimin për udhëtimin zyrtar. Autorizimin për udhëtime zyrtare për personelin e Ndërmarrjes e aprovon Kryeshefi Ekzekutiv, për zyrtarët e lartë të Ndërmarrjes Bordi i Drejtorëve, ndërsa për anëtarët e Bordit njoftohet Komisioni i Aksionëreve.
3. Meditja për udhëtimet jashtë vendit do të paguhet në bazë të Aktit Administrativ që rregullon këtë fushë

Ap.

Sp.

### **Neni 19**

#### **Kompensimi për angazhim jashtë vendit**

1. Punëtorët të cilët janë dërguar nga Ndërmarrja, jashtë vendit për të kryer punët, detyrat e punës ose shkollim në gjatësi kohore mbi 30 ditë, do të kompensohen për jetë të ndarë nga familja;
2. Vlera e kompensimit caktohet me vendim të vecantë të Kryeshefit Ekzekutiv por nuk mund të jetë me e madhe se 50% e pagës mujore të punëtorit.

### **Neni 20**

#### **Kompensimi gjatë suspendimit dhe largimit të përkohshëm**

1. Punëtorit i cili për shkak të shkeljeve të obligimeve të punës, i është shqiptuar suspendimi si masë parandaluese deri në vendimin definitiv të komisionit disiplinor, do ti kompensohet pagesa mujore në vlerë prej 50 % të pages bazë mujore;
2. Nëse pas përfundimit të shqyrtimit të lëndës nga komisioni disiplinor, punëtori shpallet i pafajshëm dhe lirohet nga përgjegjësia disiplinore, atij do ti kompensohet pjesa e pagës e ndalur gjatë kohës së suspendimit.
3. Largimi i përkohshëm nga puna nuk mund të bëhet me gjatë se 6 muaj për të cilën do të bëhet kompensimi sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Neni 21**

#### **Kompensimi për mos-shfrytëzimin e pushimit vjetor**

1. Kompensimi i pushimit vjetor të pa shfrytëzuar me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si dhe ndërprejes së pushimit vjetor të të punësuarit për nevojat e Ndërmarrjes, i bëhet për aq ditë pushim sa i kanë mbetur pa shfrytëzuar nëse pushimi nuk është lejuar nga Udhëheqësi për shkak të mbarëvajtjes së punës në Ndërmarrje;
2. Vlera e kompensimit të pushimit vjetor është ekuivalente me vlerën e punës ditore sipas kontratës për kohëzgjatjen e pushimit vjetor;
3. I punësuarit i cili nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit vjetor, ditët e mbetura të pa shfrytëzuar nga pushimi, i lejohet bartja e tyre në vitin vijues deri me 30 Qershor;

### **Neni 22**

#### **Kompensime të tjera**

1. Të punësuarve në Ndërmarrjen Pallati i Rinise u njihet e drejta e kompensimeve si më poshtë:
  - 1.1 Pagesa e shujtës ditore;
  - 1.2 Reprerentacioni/Trajnime/Përfaqësimi;

1.3 Pagesa e përvojës së punës në vlerën 0.5% në pagën bazë për cdo vit të plotë të përvojës së punës;

2. Pagesa e përcaktuar në nën paragrafin 1.1 të këtij Neni përcaktohet/ndryshohet apo shfuqizohet varësisht nga gjendja financiare e Ndërmarrjes nga Bordi i Drejtorëve.

### **Neni 23**

#### **Kompensime të vecanta**

1. Të punësuarve të NPL "Pallati i Rinise" SH.A me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, mund të ju takojnë kompensime të vecanta si me poshtë:

1.1 Në rast të vdekjes së një anëtarit të familjes së ngushtë në vlerën 150 Euro. Në kuptim të këtij neni anëtarit i ngushtë i familjes përfshin: bashkëshortët, fëmijët dhe prindërit e të punësuarve;

1.2 Stimulimi në rast festash zyrtare bazuar mbi buxhetin e miratuar për vitin kalendarik përkatës dhe vendimin e Bordit të Drejtorëve;

1.3 Bonuse në rast të tejkalimit të pritshmërive në punë;

2 Kompensimet e përcaktuara në këtë nën Kryeshefi Ekzekutiv mund ti realizoj vetëm nëse konsiderohet se Ndërmarrja është në gjendje financiare stabile.

### **Neni 24**

#### **Kompensimi me rastin e pensionimit**

Punëtorit me rastin e mbushjes së moshës së pensionimit, Ndërmarrja i ndan një kompensim me vlerë të 3 pagave mujore të periudhës së fundit, të përcaktuar sipas Nenit 77, të Ligjit të Punës Nr 03/L-212.

### **Neni 25**

#### **Kompensimi në rastin e largimit kolektiv nga puna**

Të punësuarve të Ndërmarrjes Pallati i Rinise në rast të largimit kolektiv nga puna, u bëhet kompensimi në përputhje me Nenin 76 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

### **Neni 26**

#### **Reprezentacioni/Përfaqësimi**

1. Të drejtën e reprezentacionit e ka Kryeshefi Ekzekutiv.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1, të drejtë në reprezentacion kanë zyrtarët e tjerë, me aprovim paraprak nga Kryeshefi Ekzekutiv.
3. Lartësia e reprezentacionit/përfaqësimit do të përcaktohet nga Bordi i Drejtorëve në projektionin buxhetor.

### **Neni 27**

#### **Shpenzimet e telefonisë mobile për Bordin e Drejtorëve dhe punonjesve të Ndërmarrjes**



## Aneksi 1

Titulli I pozites	Koeficienti
Vozitës i Kryeshefit Ekzekutiv	2.5
Recepcionist/e	2.2
Mirëmbajtës/Shtëpiak	2.2
Mirëmbajtës Higjienik	2.12
Furnizues	2.2
Vozitës	2.2
Kryemonitorues	2.6
Arkatar	2.33
Depoist	2.33
Zyrtar/e për planifikim të buxhetit	2.8
Zyrtar/e i/e thesarit	2.8
Zyrtar i kontabilitetit	2.8
Zyrtar i pasurisë	2.8
Zyrtar i administratës	2.5
Zyrtar i burimeve njerëzore	2.5
Zyrtar për Paga	2.5
Teknik i TI-së	3.5
Elektracist	2.3
Hidroinstalues	2.3
Punëtor sigurimi dhe zjarrëfikje	2.2
Monitorues i kamerave të sigurisë	2.2
Ndihmës Administrativ	2.3
Arkivist	2.4
Asistent Administrativ i Kryeshefit Ekzekutiv	2.5
Zyrtar për Marrëdhënie me Klient	2.5
Zyrtar për kulturë dhe sport	2.5
Zyrtar i marketingut dhe promocionit	2.5
Zyrtar i marketingut dixhital	2.5
Zyrtar Ligjor	2.5
Ekspert për shëndet dhe siguri në punë	2.8
Kryeteknik për nxemje, klimë dhe ventilim	2.45
Teknik për nxemje, klimë dhe ventilim	2.3
Kryelektracist	2.45
Kryepunëtor i shërbimit higjienik	2.5
Kryeteknik për shërbime të mirëmbajtjes dhe higjienës	2.5
Koordinator i sigurimit	2.6
Koordinator i mbrojtjes nga zjarri	2.6
Mbikëqyrës i ndërrimit i sektorit të sigurimit dhe zjarrëfikësve	2.3
Zyrtar i prokurimit	2.5
Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv	3.5
Zyrtar/e Certifikues/e	4
Përgjegjës i Sektorit teknik	4.2
Arkitekt	4

*Sp.*

Të punësuarit në Ndërmarrjen Pallati Rinise kanë të drejtë në shpenzimet e telefonisë sipas **Aneksit 2** të kësaj Rregullore.

**Neni 28**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë Aneksi 1 dhe Aneksi 2;
2. Në asnjë rast, dispozitat e kësaj Rregullore nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se dispozitat e Ligjit të Punës për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia juridike e punës;
3. Për cdo paqartësi apo konflikt të dispozitave të kësaj rregulloreje, Ligjet në fuqi dhe Statuti i Ndërmarrjes mbizotërojnë mbi këtë rregullore. Në raste të tilla dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje konsiderohen të revokuara, ose ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes me ndonjë dispozitë të Ligjeve apo Statutit të Ndërmarrjes "Pallati i Rinisë" SH.A;
4. Me hyrjen në fuqi në kësaj Rregulloreje Anulohet Rregullorja nr. 1/1336, të dt. 14.11.2024, e miratuar në mbledhjen e drejtorëve me datë 17.10.2024
5. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes.

**BORDI I DREJTORËVE:**

**ARIANA PIREVA, KRYESUESE** 

**GANI SOPI, ANËTAR** 

**VJOSA RRAHMANI, ANËTARE** 

**SHUAJB MEHMETI, ANËTAR** 



Inxhinier i elektrikës	4
Inxhinier i makinerisë	4
Përgjegjës i sektorit të sigurimit dhe zjarrëfikësve	4.2
Shef/e i Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv	4
Përgjegjës i Kontabilitetit	4.2
Përgjegjës i administratës	4.2
Përgjegjës i burimeve njerëzore	4.2
Auditor/e i/e Brendshëm/e	4.3
Udhëheqës i Zyrës së Burimeve Njerëzore	4.5
Udhëheqës i Departamentit të Administratës	4.5
Udhëheqës i Departamentit të shërbimeve afariste	4.5
Udhëheqës i Zyrës ligjore	4.5
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	4.5
Udhëheqës i Departamentit të Operativës	4.5
Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e	5.9
Zyrtar/e i/e Auditimit të Brendshëm	5.9
Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e dhe i/e Thesarit	5.9
Përgjegjës i Financave	4.2
Kryeshef Ekzekutiv	7

## Aneksi 2

<b>VLERA E MBUSHJES SË TELEFONIT:</b>
Bordi i Drejtorëve: 20 €;
Zyrtarët e Lartë: 20 €;
Menaxheri i Operativës: 20€
Udhëheqësit: 20 €;
Përgjegjësit: 20€;
Inxhinierët: 20€
Kabinet i Kryeshefes: 10€

*Ap.*

3/28/2004

1. The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records.

2. It then goes on to describe the various methods used to collect and analyze data.

3. The results of the study are presented in the following table, which shows a clear trend.

4. In conclusion, the findings of this study suggest that there is a significant correlation between the variables.

5. Further research is needed to explore the underlying mechanisms of this relationship.

6. The authors would like to thank the funding agency for their support of this project.

7. Finally, it is hoped that these findings will contribute to a better understanding of the phenomenon.

8. The data presented here is preliminary and subject to change as more information is gathered.

9. We encourage other researchers to replicate these studies to verify the results.

10. The authors have no conflicts of interest to declare.

11. This work was supported by a grant from the National Science Foundation.